

rez, ndërkaq aji ndenji me ushtarë të tjerë të UÇK-së. Në datën 22.09.1998, Abedini shkoi për vizitë te familja. Po atë ditë, forcat serbe e kanë sulmuar Qirezit/Ćirez dhe fshatrat përreth. Ditën tjetër [23.09.1998], Abedini me disa burra të tjerë tentuan të kalonin deri te fshati fqinj të Kolles/Kollo [Vushtrri/Vučitrn]. Abedini ka rënë në betejë me pjesëtarë të forcave serbe në pyllin e bjeshkës së *Çiçavicës/Ćiçavica*, përmbi fshatin *Qirez/Ćirez*. Ushtarë të UÇK-së e kanë varrosur në pyll po atë ditë. Në datën 5.11.1998, trupin e Abedinit e kanë rivarrosur në varrezat e Rezallës së Re/Ljudevik.

Burimet: deklarata A.V, FDH-32466; deklarata M.D, FDH-2748; J. Martinsen, *Regjistri..*, FDH-26092.

Behram (Hazir) Morina

(1.05.1959, shqiptar nga Gllolari/Globar, komuna e Gllogocit/Glogovac, punëtor ndërtime, pjesëtar i UÇK-së)

Behrami jetonte në bashkësi familjare me bashkëshorten, të vëllain dhe të ëmën. Nuk kishte fëmijë. Ai aderoi në UÇK në muajin qershor të vitit 1998. Ka rënë tre muaj më vonë [23.09.1998], gjatë betejës me forcat serbe [në bjeshkën e *Çiçavicës/Ćiçavica*] në pyll përmbi fshatin *Qirez/Ćirez*. Një ditë më vonë, banorët e Qirezit/Ćirez e kanë gjetur trupin e tij dhe për këtë e kanë informuar UÇK-në, në mesin e së cilës ishte edhe axha i Behramit, Xhemshiri, i cili edhe e ka identifikuar Behramin. Po atë ditë, ushtarët dhe banorët e kanë varrosur Behramin në varrezat e Qirezit/Ćirez. Pas lufte, mbetjet mortore të Behramit u rivarrosen në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Polac/Poljance.

Burimet: deklarata N.M, FDH-32022; J. Martinsen, *Regjistri..*, FDH-26092.

Elfije (Fazli) Rrustemi

(1957, shqiptare nga Aqareva/Ovçarevo, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, gjashtë fëmijë)

Në fillim të muajit shtator të vitit 1998. Elfija me fëmijët kaluan në Qirez/Ćirez, ndërkaq bashkëshorti i saj Istrefi ndenji në shtëpi.

Në datën 23.09.1998, Elfija me refugjatët dhe vendasit u detyruan të largoheshin nga Qirezi/Ćirez, sepse forcat serbe e kishin sulmuar fshatin. Elfija me fëmijët u strehuan në pyjet e bjeshkës së *Çiçavicës/Ćiçavica*, përmbi *Qirez/Ćirez*. Ka pësuar po atë ditë. E kanë qëlluar nga armë zjarri në ballë dhe në këmbët. Bashkëshorti dhe djali Hakifi e kanë varrosur në oborrin e xhamisë së fshatit në Qirez/Ćirez. Në muajin gusht të vitit 1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Elfijes në varrezat e Aqarevës/Ovçarevo.

Burimet: deklarata I.Rr, FDH-40642; J. Osmani, *Krimet..*, II, 305; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.6D00700, FDH-33284.

Bajram (Jashar) Berisha

(23.05.1958, shqiptar nga Shtutica/Štutica, komuna e Gllogocit/Glogovac, elektrikist në mihjen sipërfaqësore Bardh i Madh/Belaćevac, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Naim (Ramadan) Musliu

(23.04.1965, shqiptar nga Shtutica/Štutica, komuna e Gllogocit/Glogovac, bujk, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Naim (Kadri) Gashi

(20.01.1973, shqiptar nga Shtutica/Štutica, komuna e Gllogocit/Glogovac, bujk, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Hysni (Osman) Shabani

(26.05.1974, shqiptar nga Shtutica/Štutica, komuna e Gllogocit/Glogovac, bujk, i martuar)

Fejzë (Feriz) Ramadani

(1.03.1975, shqiptar nga Shtutica/Štutica, komuna e Gllogocit/Glogovac, bujk, i martuar, pjesëtar i UÇK-së)

Qamil (Jashar) Bajrami

(15.10.1977, shqiptar nga Shtutica/Štutica, komuna e Gllogocit/Glogovac, student i gjuhës shqipe, i pamartuar)

Elhami (Osman) Shabani

(1.09.1983, shqiptar nga Shtutica/Štutica, komuna e Gllogocit/Glogovac, nxënësi)

Banorë të Shtuticës/Štutica e braktisën më 16.09.1998 fshatin dhe u strehuan në fshatin fqinj të Likoshanit/Likošane [Gllogoc/Glogovac]. Gjashtë ditë më vonë, më